



## **Kosova Demokratik Turk Partisi ( KDTP )**

**Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur**

**01 Janar 2017 - 31 Dhjetor 2017**



Përbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	5
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	6
Shënimet e pasqyrave financiare.....	7-13



## Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Kosova Demokrat Turk Partisi

### Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

#### Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik Kosova Demokratik Turk Partisi (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “KDTP”), te përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2017, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira ne faqe 6-13.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2017, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për vitin që mbyllte në këtë datë, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174 ,Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

#### Bazat për Opinion te kualifikuar

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbrushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

- SP ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per vitin qe perfundon me 31.12.2017 ka paraqit shpenzime te qiras vleren 12,976.00 Euro per te cilat pagesa nuk ka ndal tatimin ne burim ne qera, sipas kërkesave ligjore qe burojn nga Lgji NR:05/L-028 per tatimin e mbajtur ne burim , neni-39.
- SP ka paguar paga dhe kompenzime, por që nuk janë përllogaritur dhe deklaruar tatimet dhe kontributet si tatim në burim bazuar në Ligjin Nr.05/L-28 për Tatimin në të Ardhura Personale sipas kërkesës nga neni 7 i ligjit . SP ka kontrata pune me 11 punetore qe kane marr paga per 4 muaj, kurese ne pagat e deklaruara ne ATK ka vetem 2 punetore.



- SP ne Pasqyren e pozites financiare me 31.12.2017 ka prezentuar asete ne vlore 31,350.00 Euro. Verifikimin e kemi bere vetem per nje fatur ne vlerë 24,500.00 ( ndersa per 6,850.00Euro ska pas dokumentacion mbeshtetes)

### Theksim i çështjes

Pa e kualifikuar me tej opinionin ton ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet te mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik ne blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedure te tenderimit e cila do te mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik nuk e ka te definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financierar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, nen 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore ne lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe te fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, nen 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.
- SP nuk ka shpalosur shenimet mbi pagesate kryera ne vlore mbi 5,000.00Euro nje marresi te vetem mrenda dites ashtu siq parashihet ne ligjin NR:04/L-212 per plotesimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr:03/L-174 per financimin e subjekteve politike te ndryshuar dhe te plotsuar me Ligjin Nr:04/L-058 /neni 15 Raportimi financiar.

### Përgjegjësia e drejtuesve dhe e atyre te ngarkuar me udhëheqjen e SP për Pasqyrat Financiare

Drejtuesit e Subjektit politik janë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.



Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës se kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse drejtimi synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnje alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të SP-së.

#### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrëthanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të térheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me



qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Ymer Shatri'.

Ymer Shatri

Auditor ligjor

12 Prill 2019



### Pasqyra e Pozitës Financiare

Me 31 Dhjetor 2017

<b>Pasuritë</b>	Shënim	<b>Me 31 Dhjetor</b>	<b>Me 31 Dhjetor</b>
		2017	2016
<b>Pasuritë afatgjata</b>		<b>Shuma në Euro</b>	<b>Shuma në Euro</b>
Toka, objektet dhe pajisjet	2	16,332.00	19,467.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
<b>Total pasuritë afatgjata</b>		<b>16,332.00</b>	<b>19,467.00</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Llogaritë e arkëtueshme		0	0
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	14.51	3,100.41
Pasuritë tjera afatshkurtra			
<b>Total pasuritë afatshkurtra</b>		<b>14.51</b>	<b>3,100.41</b>
<b>Total pasuritë</b>		<b>16,346.51</b>	<b>22,567.41</b>
<b>Ekuiteti</b>			
Fondet e akumuluara		2,016.55	-2,728.00
Suficiti / (deficiti) i viti		-17,642.04	4,744.55
<b>Total Ekuiteti</b>		<b>-15,625.49</b>	<b>2,016.55</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera	2	16,332.00	19,467.00
<b>Gjithsej detyrimet agatgjata</b>		<b>16,332.00</b>	<b>19,467.00</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	4		
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	5	15,640.00	1,084.00
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>15,640.00</b>	<b>1,084.00</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>31,972.00</b>	<b>21,134.00</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>16,346.51</b>	<b>22,567.41</b>

### Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Viti që përfundon me 31 Dhjetor		
	Shënim	2017	2016
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat nga buxheti		63,000.00	63,000.00
Të hyrat nga anëtarësia		1,020.00	4,300.00
Donacionet dhe kontributet në të holla			
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime			
Të hyrat e fushatës		5,900.00	
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera		3,135.00	3,083.36
Të hyrat tjera			55.97
<b>Gjithsej të hyrat për vitin</b>		<b>73,055.00</b>	<b>70,439.33</b>
 <b>Shpenzimet</b>			
Pagat dhe kompenzimet	6	8,896.78	8,440.00
Shpenzimet e transportit	6	2,046.73	4,423.36
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	6	168.40	10,807.23
Shpenzimet e fushatës	6	59,451.93	
Blerja e mallrave	6	575.40	
Shpenzimet e përgjithshme	6	18,379.26	21,211.47
Shpenzimet e ndryshme	6	1,178.54	2,019.30
<b>Gjithsej shpenzimet për vitin</b>		<b>90,697.04</b>	<b>46,901.36</b>
 <b>Sufici / (deficit) për vitin</b>		<b>-17,642.04</b>	<b>23,537.97</b>

## **1. Informata te përgjithshme**

Kosova Demokratik Turk Partesi KDTP

E themeluar: 2001

Kryetar : Mahir Jagcilar

Zyrtar finanziar: Sezer Hoti

Selija: Prizren

Pasqyrat financiare te KDTP-së janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, nen 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 ,Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar reportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vetme bankare ne bankën: NLB.

**Shënim i 2. Toka, objektet dhe pajisjet**  
**Me 31 Dhjetor 2017**

	Bilanci në fillim të vittit (kosto historike)	Blerjet gjatë vittit	Amortizimi i akumular	Amortizimi i vittit	Bilanci në fund të vittit (vlera neto)
Toka					0
Objektet					0
Veturat	24,500		9,350	2,450	12,700.00
Pajisjet e zyrës	5,318		1,829	532	2,957.20
Pajisjet e teknologjisë informative	1,532		704	153	674.80
Pajisjet tjera	-	-	-	-	
<b>Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet:</b>	<b>31,350.00</b>	<b>0.00</b>	<b>11,883.00</b>	<b>3,135.00</b>	<b>16,332.00</b>

**Shënim i 3. Paraja dhe ekuivalentet e parasë**

	<b>Me 31 Dhjetor 2017</b> <b>Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2016</b> <b>Shuma në Euro</b>
Paraja në bankë	14.51	3,100.41
Paraja në arkë		
<b>Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>14.51</b>	<b>3,100.41</b>

**Shënim i 4. Detyrimet tjera afatshkurtër**

	<b>Me 31 Dhjetor 2017</b> <b>Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2016</b> <b>Shuma në Euro</b>
Detyrimet për paga dhe tatime		
Detyrimet për qira		
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)	15,640.00	1,084.00
<b>Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>15,640.00</b>	<b>1,084.00</b>

**Shënimi 6 . Shpenzimet**

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
<b>Pagat dhe kompensimet</b>			
Pagat dhe kompensimet, neto	8,640.00	8,640.00	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	23.45	23.45	0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit	23.45	23.45	0.00
Tatimet në të ardhura personale	209.88	209.88	0.00
Beneficionet tjera			0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>8,896.78</b>	<b>8,896.78</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e transportit</b>			
Automjetet motorike të huazuara			0
Karburantet	513.00	513.00	0
Biletat, aeroplani/autobusit/trenit/taksit etj.	1,295.00	1,295.00	0
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave			0
Çdo shpenzim tjetër i transportit	238.73	238.73	0
<b>Gjithsej shpenzimet e transportit</b>	<b>2,046.73</b>	<b>2,046.73</b>	<b>0.00</b>
<b>Reklama, promovimi,reprezentacioni, konferencia</b>			
Lokali			0.00
Ushqimi	168.40	168.40	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta			0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave			0.00
<b>Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat</b>	<b>168.40</b>	<b>168.40</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e fushatës</b>			
Shpenzimet e fushatës	59,451.93	49,701.93	9,750.00
<b>Gjithsej shpenzimet e fushatës</b>	<b>59,451.93</b>	<b>49,701.93</b>	<b>9,750.00</b>
<b>Blerja e mallrave</b>			
Furnizimi i zyrës	575.40	575.40	0

**Kosova Demokrat Turk Partisi**

Shënimë për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2017 deri më 31 Dhjetor, 2017

Pajisjet të vogla			0
Gjithsej blerja e mallrave	575.40	575.40	0.00
<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>			
Qiraja e lokalit të zyrës	12,976.00	7,086.00	5,890.00
Telefoni, interneti dhe posta	568.17	568.17	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	1,700.09	1,700.09	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	3,135	//////////	
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyrë në mallra dhe shërbime		//////////	
<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>18,379.26</b>	<b>9,354.26</b>	<b>5,890.00</b>
<b>Shpenzimet e ndryshme</b>			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			0
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnje kategori tjeter	1,178.54	1,178.54	0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e ndryshme</b>	<b>1,178.54</b>	<b>1,178.54</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>90,697.04</b>	<b>71,922.04</b>	<b>15,640.00</b>